

VENDIM
Nr. 175, datë 7.7.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “M&K ENERGY TRADING CO” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.7.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 965/3 prot., datë 1.7.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “M&K Energy Trading Co” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “M&K Energy Trading Co” sh.p.k., me shkresën nr. 964 prot., datë 24.6.2022, ka përcjellë në ERE aplikimin e saj për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, nga ERE, në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe dokumentacionit teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim – neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor – neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal – neni 9, pika 3, germat “a”, “b”;
- dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike – neni 9, pika 4.8, germat “a”, “b”, “c”.

Në lidhje me dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

Dokumentacioni financiar dhe fiskal – neni 9, pika 3, germa “c” dhe neni 9, pika 4.8, germa “b”:

Shoqëria duhet të depozitojë në ERE deklaratën e ortakëve të saj për konfirmimin e mbështetjes financiare për këtë veprimtari.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “M&K Energy Trading Co” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

